

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe nenit 124 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/15 dhe 65/18), duke vepruar sipas propozimit për shpalljen e pavlefshme të vendimit të dorëzuar nga Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial në seancën e mbajtur më 15.07.2024, mori

AKTVENDIM

1. Propozimi Pa.nr.10-92 i datës 20.06.2024 (nr. 13-800/2 i datës 19.06.2024) i Drejtorisë për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial për shpallje të pavlefshme të Vendimit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës Pa.nr.10-110 i datës 10.08.2022, PRANOHET.
2. Vendimi i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës Pa. nr. 10-110 i datës 10.08.2022, SHPALLET I PAVLEFSHËM SEPSE ZBATIMI I TIJ NUK ËSHTË NË ASNJË MËNYRË I MUNDUR.

Arsyetim

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: KMK) me shkresën nr.10-92 të datës 31.05.2024 kërkoi nga Drejtoria për Zona të Zhvillimit Teknologjik Industrial (DZZHTI) të prononcohet zyrtarisht në lidhje me informacionet në media se "Marrëveshja për dhënien e ndihmës shtetërore ndaj Shoqatës për prodhim, tregti dhe shërbime NEXT.E.GO MOBILE, NEXT.E.GO MOBILE SHPKNJP import-eksport Tetovë po ndërpritet për shkak të jo likuiditetit të kompanisë "mëmë", si dhe çdo procedurë e parashikuar për dhënien e mjeteve publike. Duke marrë parasysh sa më lart, KMK kërkoi nga DZZHTI të prononcohet nëse është i mundur realizimi i projektit investues për prodhimin e automjeteve të Shoqatës për prodhim, tregti dhe shërbime NEXT.E.GO MOBILE, NEXT.E.GO MOBILE SHPKNJP import-eksport Tetovë.

DZZHTI më 19.06.2024 dorëzoi shkresën nr.13-800/2 (numri ynë 10-92 i datës 20.06.2024) me propozim drejtuar KMK-së që të shpallë të pavlefshëm Vendimin e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës Pa.nr.10-110 të datës 10.08.2022.

DZZHTI me shkresën nr. 13-800/2 të datës 19.06.2024 informoi KMK-në dhe konfirmoi se pas informacioneve të marra për jo likuiditetin të kompanisë "mëmë", e cila është themeluese/pronare sipas të dhënave nga Regjistri Qendror, investimi i planifikuar i Shoqatës për prodhim, tregti dhe shërbime NEXT.E.GO MOBILE, NEXT.E.GO MOBILE SHPKNJP import-eksport Tetovë për prodhimin e automjeteve po ndërpritet dhe nuk do të realizohet. Gjithashtu, DZZHTI informoi KMK-në se deri në momentin e marrjes së informacioneve për jo likuiditetin të kompanisë "mëmë", NEXT.E.GO MOBILE, NEXT.E.GO MOBILE SHPKNJP import-eksport Tetovë nuk ka marrë ndihmë shtetërore në asnjë bazë, në përputhje me Marrëveshjen për dhënien e ndihmës shtetërore.

Gjithashtu, në shkresën e DZZHTI-së theksohet se nuk ekziston mundësia për zbatimin e Vendimit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës Pa.nr.10-110 të datës 10.08.2022.

Pas shqyrtimit të propozimit të DZZHTI-së për shpalljen e Vendimit të KMK-së Pa. nr. 10-110 të datës 10.08.2022 si të pavlefshëm, KMK konstatoi se:

KMK me Vendimin nr. 10-110 të datës 10.08.2022 konstatoi se ndihma e planifikuar përbën ndihmë shtetërore dhe e njëjta është e lejuar si ndihmë individuale rajonale në përputhje me nenin 4 paragrafi (1) pika 2 dhe pika 11 e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, dhe konstatoi se një pjesë e ndihmës së planifikuar përbën dhënie të ndihmës shtetërore përmes një skeme ndihme të parashikuar në Ligjin për Zonat e Zhvillimit Teknologjik Industrial.

Në propozimin e DZZHTI-së nr. 13-800/2 të datës 19.06.2024 është theksuar se investimi i planifikuar i NEXT.E.GO MOBILE, NEXT.E.GO MOBILE SHPKNJP import-eksport Tetovë për prodhimin e automjeteve po ndërpritet dhe nuk do të realizohet për shkak të jo likuiditetit të kompanisë "mëmë".

KMK këtë e pranon si arsye për të cilën Vendimi i KMK-së Pa. nr. 10-110 i datës 10.08.2022 nuk mund të zbatohet në asnjë mënyrë dhe e shpall atë TË PAVLEFSHËM.

Në bazë të sa më sipër, KMK vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Udhëzim për mjetin juridik: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij. Padia nuk e shtyn zbatimin e vendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска